



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:276126

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06342641

C.nr.803/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE – DEGA NE SKDNERAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Durim Osmani, në çështjen juridike kontestimore, sipas padisë së paditëses M.A. nga fshati..., Komuna ne Skenderaj, i përfaqësuar nga Avokate Sh.M.S., rruga..., kundër të paditurës Komuna e Skenderajit, Drejtoria e Arsimit, ne Skenderaj, me objekt kontesti, marrëdhënie e punës, jashtë seancës gjyqësore, duke vepruar sipas parashtresës se paditëses të datës 23.10.2024, jashtë seancës gjyqësore, me datën 24.10.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

- I. REFUZOHET** e pabazuar kërkesëpadia e paditëses M.A. nga fshati..., Komuna e Skenderajit, me te cilën ka kërkuar qe te Komuna ne Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit ne Skenderaj qe paditësin ta marr ne pune dhe ne detyra te punës se edukatores për grup mosha 3-6 vjeç me te gjitha te drejtat qe dalin nga vendi i punës.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësja përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë ka ushtruar padi dhe kërkesëpadi me datë 01.08.2024, kundër të paditurës me objekti kontesti, Anulim vendimi dhe kthim ne pune.

Përfaqësuesi i paditëses me parashtresën e datës 23.10.2024, ka heqë dorë nga kërkesëpadia ndaj palës së paditur, me arsyetim se të njëjtin ka lidhur kontrate te punës dhe se nuk ka interes qe te vazhdoj procedurën kontestimore.

Gjykata, bazuar në nenin 3 paragrafin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka vlerësuar se palët në këtë procedurë, mund të disponojnë lirisht me kërkesat e tyre juridiko-civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës, andaj pasi që janë plotësuar kushtet e nevojshme ligjore, ka marr aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia siç është vendosur në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, bazuar në nenin 149 paragrafi 2 i LPK-së, nuk e ka njoftuar të paditurën paraprakisht pasi që sipas dispozitës së lartcekur, nuk është i nevojshëm pëlqimi i të paditurës, kur paditësi heqë dorë nga kërkesëpadia.

Gjykata, bazuar në nenin 160 paragrafi 6 të LPK-së, në pjesën arsyetuese të këtij aktgjykimi, ka dhënë arsye vetëm për justifikimin e dhënies së këtij lloji të aktgjykimit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës, gjykata i bazoi në nenin 450 të LPK-së, me ç ‘rast e ka vendos që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale.

Në bazë të dhënave si ma lartë, si dhe në bazë të neneve 142, 143, 160 si dhe 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE – DEGA NE SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr. 803/2024, me datë 23.10.2024

Gjyqtari

Durim Osmani

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kuptim të nenit 181 paragrafi*